



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

PROJEKTVENDIM

Nr 5176/1, Datë 26/03/2021

PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2021 DHE PBA 2021-2023

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin përkatës Këshillit të Bashkisë,

Për të vendosur :

1.Miratimin e një ndryshimi në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 si më poshtë:

1/a-Të paksohen shpenzimet në programin buxhetor “Rrjeti Rrugor Rurale” në shumën 14,519,000 lekë për objektin: “Rehabilitim i qendrave të fshatrave Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Balldre, Gocaj e Blinsht”.

1/b-Të shtohet shpenzimet në programin buxhetor “Menaxhimi i Mbetjeve” në shumën 14,519,000 lekë.

Për këtë të kryhen veprimet si më poshtë :

- Pakësohet : Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.231 në shumën 14,519,000 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.05100, Kap.05, Art.602 në shumën 14,519,000 lekë.

2.Te shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Menaxhimi i Mbetjeve” në shumën 14,519,000 lekë per vitin 2022 në PBA 2021-2023 , te pakesohen shpenzimet në programin buxhetor “Rrjeti Rrugor Rurale” në shumën 14,519,000 lekë për objektin “Investim per sistemimin e rrugeve urbane “ ne vleren 14 519 000 lekë.

3. Te shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Menaxhimi i Mbetjeve” në shumën 14,519,000 lekë per vitin 2023 në PBA 2021-2023 , te pakesohen shpenzimet në programin buxhetor “Rrjeti Rrugor Rurale” në shumën 14,519,000 lekë për objektin “Investim per sistemimin e rrugeve urbane “ ne vleren 14 519 000 lekë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.

5. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Pjerin NDREU

